

KËRKESË
Nr. 3097/1, datë 28.8.2023

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR “SHËRBIME KONSULENCE PËR
MBIKËQYRJEN E REHABILITIMIT TË SPITALIT TË LEZHËS”, PËRFITUES I SË
CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Asistencë Teknike Lokale – Kompani Konsulence

Tiranë, 28 gusht 2023

Financimi Shtesë i Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor Shqiptar (HSIP)

Nr. huaje: 93060

Numri ID i Projektit: P144688

Titulli i detyrës: Shërbime konsulence për mbikëqyrjen e rehabilitimit të Spitalit të Lezhës

Referenca nr. AL-MH-371202-CS-CQS

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim shtesë, në vlerën 25 milionë euro për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, një hua të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për të shkallëzuar aktivitetet e Projektit mëmë dhe për të siguruar direkt ndikimin të përfituesit dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) vepron si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Shëndetësisë (MSHMS), më poshtë referuar si “Klienti”, ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin dhe koordinimi i Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të tij të Menaxhimit të Projektit (PMT). Objektivi i Projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Projektin përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i Menaxhimit dhe i Infrastrukturës së Spitaleve

Pjesa 2. Përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor/*e-Shëndetësisë* për shërbimet spitalore

Pjesa 3. Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i Projektit

Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore që rrjedh nga masterplani i spitaleve si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe të përmirësimit të cilësisë së spitaleve. Urgjenca e racionalizimit dhe e përmirësimit të rrjetit spitalor është shtuar më tej nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti. Sa më sipër do të bëhet e mundur përmes racionalizimit të spitaleve të mëdha, transformimit të aktiviteteve dhe të shërbimeve aktuale spitalore në një institucion shëndetësor më dinamik dhe më vetefikas, duke përdorur një qasje të integruar që adreson rehabilitimin e infrastrukturës, pajisjet moderne diagnostike dhe optimizimin e personelit të kujdesit shëndetësor. Mbështetur në rezultatet e Projektit mëmë (si modernizimi i pajisjeve diagnostikuese mjekësore në 11 spitale rajonale, rikonstruksioni i Spitalit Pediatrik në spitalin “Nënë Tereza”, godina e re e Spitalit të Laçit) aktivitetet e parashikuara nga financimi shtesë përputhen plotësisht me agjendën e zgjeruar të reformës dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të kujdesit spitalor. Rindërtimi i spitaleve rajonale dhe bashkiake do të japë një mundësi për të zbatuar HMP-në e përditësuar. Rezultatet e Projektit mëmë kanë inkurajuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në ndjekjen e një reforme më të thellë në nivelin sekondar të kujdesit, duke filluar me përmirësimin e mëtejshëm të kujdesit

diagnostik, optimizimin e plotë të shërbimeve spitalore rajonale, transformimin e shërbimeve në spitalet e përzgjedhura bashkiake dhe zbatimin e sistemit të informacionit shëndetësor në spitalet rajonale. Përmirësimi i sistemit të kujdesit shëndetësor spitalor në vend në të gjitha nivelet e tij, duke filluar nga forcimi i menaxhimit dhe i qeverisjes për shërbimet spitalore publike, marrëveshjet e financimit shëndetësor, sistemet e informacionit, për përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në Shqipëri vazhdon të jetë një objektiv kryesor për qeverinë e Shqipërisë.

Shërbimi që kërkohet të kryhet sipas këtyre termave të referencës financohet për shkak të kuadrit ligjor shqiptar për praninë e një mbikëqyrësi të licencuar për mbikëqyrjen e punimeve civile. Një nga aktivitetet e financuara në kuadër të komponentit 1 (nënkomponenti 1.2, “Përmirësimi i infrastrukturës spitalore dhe menaxhimit të pajisjeve mjekësore”) është aktiviteti “Punimet civile për rehabilitimin e Spitalit Rajonal Lezhë” (që do të monitorohet nëpërmjet një kompanie, e cila do të zgjidhet sipas këtij ToR-je.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon që firmat vendëse të kryejnë këtë detyrë, të cilat plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Konsulenti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Kjo detyrë do të kryhet nga një firmë vendëse, e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit, rregullave dhe rregulloreve shqiptare.

- Kompania Konsulente duhet të ketë të paktën 5 vjet përvojë në menaxhimin e ndërtimeve (mbikëqyrja e ndërtesave publike).

- Aftësi për të komunikuar dhe për të përgatitur dokumentet në të dyja gjuhët: shqip dhe anglisht.

- Referenca ose prova për të paktën 3 kontrata mbikëqyrjeje në 5 vjetët e fundit të kryera në territorin shqiptar (paraqitja e kontratave të ekzekutuara)

- Shoqëria Konsulente duhet të jetë në gjendje të sigurojë në versionin origjinal ose ligjor të certifikuar, licenca profesionale të vlefshme për mbikëqyrjen, si më poshtë:

- Konsulenti duhet të ketë një licencë të vlefshme “Mbikëqyrje”, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, duke përfshirë të gjitha kategoritë që mbulojnë punët e kërkuara sipas kësaj detyre.

- Konsulenti duhet të jetë i certifikuar, për:

- ISO 9001- 2008 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

- ISO 14001-2004 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)

- OHSAS 18001-2007/ISO 45001 (stafi i konsulentëve kyç të sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë duhet të përbëhet nga stafet e mëposhtme, të cilat duhet të plotësojnë kriterin përkatës të mëposhtëm)

Kompania konsulente duhet të ketë licencat e mëposhtme të vlefshme të mbikëqyrjes:

NP - 1 (punimet e gërmimit në tokë)

NP - 3 (rikonstruksion dhe mirëmbajtje objektsh civilë dhe industriale, veshje fasadash)

NP - 7 (tubacionet e ujit, tubacionet e gazit, tubacionet e naftës, punimet e kullimit dhe të ujitjes)

NS - 1 (punimet për prishjen e objekteve)

NS - 2 (hidrosanitare, kuzhina, lavastovilje, mirëmbajtje)

NS - 4 (punimet e rifiniturës së muraturës dhe të ngjashme, rifinitura me materiale druri, plastikë, metali dhe qelqi dhe rifinitura teknike të ndërtimit)

NS - 3 (sistemi i transportuesit ngritës)

NS - 12 (uzinat teknologjike, termike dhe të ajrit të kondicionuar)

NS - 14 (shtëpiake, elektrike, telefonike, radiotelefonike, TV etj.)

Konsulenti duhet të ketë staf adekuat për të kryer aktivitetet sipas kësaj detyre. Kualifikimet e pozicioneve kyçe përfshijnë:

Inxhinier civil - lideri i ekipit

- Të ketë diplomë në inxhinieri ndërtimi;

- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim në anglisht;
- Të ketë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në mbikëqyrjen e ndërtesave publike.

- Kualifikimet në vlerësimin sizmik dhe/ose forcimin e strukturave të ndërtesave do të jenë një aset.

Arkitekt

- Të ketë diplomë në arkitekturë;
- Aftësitë drejtuese dhe menaxheriale;
- Të jetë në gjendje të komunikojë rrjedhshëm dhe të raportojë në anglisht me shkrim;
- Të ketë së paku (10) dhjetë vjet përvojë pune të përgjithshme relevante në mbikëqyrjen e ndërtesave publike;
- Eksperienca të mëparshme me përgatitjen dhe ekzekutimin e kontratave të punës sipas procedurave të BB-së;
- Përvoja e mëparshme e punës si udhëheqës ekipi në mbikëqyrje do të jetë një avantazh.

Inxhinier elektrik

- Të ketë diplomë në inxhinieri elektrike;
- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim në anglisht;
- Të ketë një minimum prej (10) dhjetë vjetësh përvojë në multidisiplinare, mbikëqyrjen e publikut, ndërtesat dhe koordinimi i tyre.

Inxhinier mekanik

- Të ketë diplomë në inxhinieri mekanike;
- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim, si në shqip ashtu edhe në anglisht;
- Të ketë së paku (10) dhjetë vjet përvojë pune relevante në mbikëqyrjen e ndërtesave publike.

Ekspert i mjedisit

- Duhet të ketë një diplomë në inxhinieri mjedisore ose një fushë të ngjashme, si inxhinieri civile, kimike ose e përgjithshme. Punëdhënësit vlerësojnë, gjithashtu, përvojën praktike;
- Aftësi për të komunikuar dhe për të raportuar me shkrim në shqip dhe në anglisht;
- Duhet të ketë një minimum prej (5) pesë vjetësh përvojë pune përkatëse në fushën e inxhinierisë mjedisore.

Konsulentit mund të ofrojnë, gjithashtu, ekspertë jokyç.

Shënim. Të gjithë ekspertët e mësipërm duhet të kenë licenca profesionale të lëshuara nga autoritetet shqiptare në fushën e ekspertizës së tyre, sipas pikës 7 më sipër, “Kualifikimi i konsulentëve”

Firma e cila do të zgjidhet (pas përmbushjes së kërkesave minimale të kualifikimit/përvojës më lart) si e renditur më lart në bazë të kriterëve të vlerësimit/listës së shkurtër më poshtë, do të ftohet për negociata për kontratën, gjatë së cilës, firmave të suksesshme do t’u kërkohet të përmbushin çelësin e mësipërm, kualifikimi i personelit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, tani fton kompanitë konsulente të kualifikuara (“Konsulentët”) të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e Shërbimeve. Kompanitë Konsulente duhet të ofrojnë informacion që tregon se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet (siç përshkruhet më sipër). Kriteret e vlerësimit/përzgjedhjes janë:

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët
1	Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e detyrës	30
2	Numri i kontratave të lidhura me detyrën e përfunduar gjatë pesë vjetëve të fundit	60
3	Disponueshmëria e stafit kyç të kualifikuar brenda firmës	10
TOTAL		100 pikë

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është Kualifikimi i Konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara të Bankës Botërore, rregulloret e prokurimit për Huamarrësit e IPF-së (prokurimi në financimin e projekteve të investimeve të mallrave, punëve, shërbimeve jokonsulente dhe këshilluese, korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018). Vëmendje u kushtohet rregullave të BB-së për konfliktin e interesit.

Konsulenti do të angazhohet gjatë zbatimit të punimeve (e parashikuar për një periudhë 16-mujore), duke përfshirë DLP-në për 1 vit. Sidoqoftë, detyra duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2024.

Kontrata do të jetë e bazuar në kohë dhe konsulenti do të dorëzojë *timesheet* dhe raporte mujore. Gjithashtu, artikujt e listuar në seksionin e mësipërm “Skedula e produkteve”. Kontributi total i të gjithë ekspertëve është vlerësuar 150 ditë pune (për të gjithë stafin së bashku).

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 (të premten), në adresën e mëposhtme. Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë ose me *e-mail*) deri më **12 shtator 2023**.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Adresa: Rruga e Kavajës Tiranë - Shqipëri

Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (HSIP)

Att: Blerina Dudushi

E-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Financim shtesë për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor
(IBRD - Huaja nr. 9306-AL)**

KUSHTET E REFERENCËS

Shërbime konsulence për mbikëqyrjen e rehabilitimit të Spitalit të Lezhës

1. HYRJE

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim shtesë, në vlerën 25 milionë euro për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, një hua të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për të shkallëzuar aktivitetet e Projektit mëmë dhe për të siguruar direkt ndikimin të përfituesit dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) vepron si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Shëndetësisë (MSHMS) më poshtë referuar si “Klienti” ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin dhe koordinimi i Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të tij të Menaxhimit të Projektit (PMT). Objektivi i Projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës së spitaleve

Pjesa 2. Përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor/*e-Shëndetësisë* për shërbimet spitalore

Pjesa 3. Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i Projektit

Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore që rrjedh nga masterplani i spitaleve, si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe

përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe të përmirësimit të cilësisë së spitaleve. Urgjenca e racionalizimit dhe përmirësimit të rrjetit spitalor është shtuar më tej nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti. Sa më sipër do të bëhet e mundur përmes racionalizimit të spitaleve të mëdha, transformimit të aktiviteteve dhe shërbimeve aktuale spitalore në një institucion shëndetësor më dinamik dhe më vetefikas, duke përdorur një qasje të integruar që adreson rehabilitimin e infrastrukturës, pajisjet moderne diagnostike dhe optimizimin e personelit të kujdesit shëndetësor. Mbështetur në rezultatet e Projektit mëmë (si modernizimi i pajisjeve diagnostikuese mjekësore në 11 spitale rajonale, rikonstruksioni i Spitalit Pediatrik në spitalin “Nënë Tereza”, godina e re e Spitalit të Laçit) aktivitetet e parashikuara nga financimi shtesë përputhen plotësisht me agjendën e zgjeruar të reformës dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të kujdesit spitalor. Rindërtimi i spitaleve rajonale dhe bashkiake do të japë një mundësi për të zbatuar HMP-në e përditësuar. Rezultatet e Projektit mëmë kanë inkurajuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në ndjekjen e një reforme më të thellë në nivelin sekondar të kujdesit, duke filluar me përmirësimin e mëtejshëm të kujdesit diagnostik, optimizimin e plotë të shërbimeve spitalore rajonale, transformimin e shërbimeve në spitalet e përzgjedhura bashkiake dhe zbatimin e sistemit të informacionit shëndetësor në spitalet rajonale. Përmirësimi i sistemit të kujdesit shëndetësor spitalor në vend në të gjitha nivelet e tij, duke filluar nga forcimi i menaxhimit dhe të qeverisjes për shërbimet spitalore publike, marrëveshjet e financimit shëndetësor, sistemet e informacionit për përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në Shqipëri, vazhdon të jetë një objektiv kryesor për qeverinë e Shqipërisë.

Shërbimi që kërkohet të kryhet sipas këtyre termave të referencës financohet për shkak të kuadrit ligjor shqiptar për praninë e një mbikëqyrësi të licencuar për mbikëqyrjen e punimeve civile. Një nga aktivitetet e financuara në kuadër të komponentit 1 (nënkomponenti 1.2, “Përmirësimi i infrastrukturës spitalore dhe menaxhimi i pajisjeve mjekësore”) është aktiviteti “Punët civile për rehabilitimin e Spitalit të Lezhës” (i cili do të monitorohet nëpërmjet një kompanie e cila do të përzgjidhet sipas këtij ToR-je).

2. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Objektivat specifikë të kësaj detyre janë të ofrojë aktivitetet e mëposhtme: mbikëqyrja e punëve civile për rehabilitimin e Spitalit të Lezhës

3. DETYRAT E SHËRBIMIT

- Ndhmon përfituesin për marrjen e lejes për punime rindërtimi, sipas kërkesave përkatëse të ligjit shqiptar;

- Ndhmon përfituesin në marrjen e lejes së rindërtimit për fillimin e punimeve civile sipas kërkesave përkatëse të ligjit shqiptar;

- Kryen mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, duke përfshirë instalimet e të gjitha sistemeve të brendshme (elektrike, mekanike, antizjarr, me ajër të kondicionuar etj.), sipas projekteve dhe specifikimeve;

- Ndhmon MSHMS-në në administrimin e kontratës së punëve civile.

- Përgatit dhe miraton ndryshimin e porosive ose përdorimin e rasteve të parashikuara, bazuar në kërkesat teknike, dhe e dorëzon atë në MSHMS/PCU;

- Administrimin, miratimin e punimeve të përfunduara dhe lehtësimin e dorëzimit të tyre nga Kontraktori tek MSHMS-ja, i cili më pas do t'i transferojë asetet autoriteteve përfituese, sipas ligjit shqiptar. Siguron që të gjitha dokumentet e nevojshme ligjore dhe teknike gjatë punës së mbikëqyrjes të ruhen për një periudhë të përcaktuar në ligjin shqiptar dhe periudhën e përgjegjësisë së kontratës së punimeve;

- Autorizon dhe konfirmon testimin dhe vënien në punë të të gjitha sistemeve të brendshme dhe të jashtme;

- Ndhmon në zbatimin e Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe të Planit Afatmesëm të

Menaxhimit të Mbetjeve;

- Të ndihmojë Ministrinë e Shëndetësisë gjatë periudhës së përgjegjësisë për defekte, në lidhje me veprimet dhe punët korrigjuese që do të kryhen nga Kontraktori; dhe

- Të zbatojë dispozitat në fuqi të ligjit shqiptar në lidhje me mbikëqyrjen e punimeve.

4. FAZA E DETYRIMEVE

Mbikëqyrja e punëve civile për rehabilitimin e Spitalit të Lezhës. Konsulenti do të kryejë mbikëqyrje/inspektim teknik të përditshëm në terren të punimeve rehabilituese në emër të MSHMS-së/PCU-së, me përgjegjësi për detyrat e mëposhtme:

I. Dorëzimi i sheshit

Konsulenti duhet të:

- lëshojë njoftimin e dorëzimit të kantierit te Kontraktori/ve, sipas kontratës, në koordinim me përfituesin;

- kontrollojë dhe miratojë vizatimet e Kontraktori/ve;

- shënojë ndërtesat brenda zonës sipas ndërtesës;

- sigurojë për përdorim të Kontraktori të gjitha të dhënat e nevojshme gjeodezike për vendndodhjen e komponentëve të Projektit;

- sigurojë të gjitha informacionet e tjera të nevojshme plotësuese për përdorimin e Kontraktori;

- t'i prezantojë Kontraktori detyrimet e tij lidhur me zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM);

- kontrollojë dhe rekomandojë për miratim orarin e punës së Kontraktori dhe çdo program tjetër që Kontraktori është i detyruar të paraqesë për miratimin e Klientit dhe autorizon Kontraktorin për fillimin e punimeve;

- përgatisë një program për kontrollin e cilësisë, në përputhje me Projektin dhe specifikimet e Projektit, duke përfshirë testet e materialeve dhe të organizojë të gjitha testimet e materialeve për të siguruar që cilësia e specifikuar në dokumentet e kontratës është marrë dhe se punimi i arritur përmbush standardet e kërkuara në kode të praktikës;

- nivelet e kantierit, kufijtë dhe përcaktimi: verifikimi i saktësisë së vendosjes së punimeve dhe të niveleve dhe të marrë të gjitha matjet e nevojshme për përcaktimin e sasive përfundimtare.

II. Ecuria e punimeve

Konsulenti duhet të:

- përgatisë orarin/programin për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së kontratës;

- kontrollojë dhe të monitorojë që cilësia e punimeve të kryhet sipas përcaktimeve të kontratës dhe specifikimeve teknike të miratuara nga "Klienti", si dhe në përputhje me rregulloret teknike ekzistuese tashmë në Republikën e Shqipërisë;

- kontrollojë dhe të miratojë që sasia e punimeve të faturuara nga Kontraktori të jetë në përputhje me progresin e bërë në kantier dhe sipas dispozitave të kontratës dhe BoQ;

- sigurojë respektimin e vizatimeve dhe specifikimeve gjatë ndërtimit;

- t'i dorëzojë Kontraktori të gjitha vizatimet, specifikimet dhe oraret plotësuese të nevojshme për kryerjen e punimeve në mënyrë që të arrihet performanca e duhur;

- shqyrtojë dhe të miratojë dokumentet dhe vizatimet e paraqitura nga Kontraktori;

- mbajë një libër matjeje për çdo vend dhe të miratojë faturat e Kontraktori (duke i nënshkruar ato);

- ndihmojë dhe të këshillojë MSHMS-në/PCU-në dhe/ose përfaqësuesin përfitues, në lidhje me pezullimin, ndërprerjen ose reduktimin e kërkesës për pagesa të paraqitura nga Kontraktori, nëse cilësia ose sasia e punimeve nuk është në përputhje me BoQ-në dhe dispozitat e kontratës ose nuk përputhet me kërkesat teknike ekzistuese në Republikën e Shqipërisë;

- verifikojë dhe të përcaktojë çmimin për njësi (duke përdorur referencat e tregut) dhe sasi të për artikujt e rinj (që nuk përfshihen në BoQ-në origjinale), të cilat do të nevojiten për punë shtesë. Punëdhënësi ka autoritetin për miratimin përfundimtar të punëve shtesë që bëhen të nevojshme gjatë kryerjes së punimeve civile në këtë kontratë. Miratimi përfundimtar i punëdhënësit do të jepet pasi kompania konsulente të ketë dhënë arsyetimet e duhura dhe të provojë domosdoshmërinë e tyre nga pikëpamja teknike;

- inspekton dhe teston gjatë prodhimit materialet, makineritë dhe impiantet (ato zakonisht inspektohen dhe testohen nga arkitektë dhe inxhinierë) dhe mbikëqyr të gjitha testet e pranimit arkitektonik dhe inxhinierik;

- kontrollon aplikacionet e Kontraktorit për pagesë, përgatit vlerësimet e ndërmjetme për certifikatat dhe qëllimet e kontabilitetit dhe lëshon certifikata që autorizojnë pagesën për Kontraktorin në përputhje me kushtet e kontratës;

- lëshon urdhra ndryshimi në emër të Klientit dhe negocion dhe bie dakord mbi kostot e urdhrave të ndryshimit me Kontraktorin;

- vlerëson pretendimet e Kontraktorit për pagesa shtesë dhe/ose zgjatje të kohës së kontratës dhe këshillon Klientin për aplikimin e dëmeve të likuiduara në përputhje me kushtet e kontratës;

- lëshon autorizimin me shkrim Kontraktorit të punëve civile për fillimin e punimeve në çdo kantier;

- përgatit dhe dorëzon te Klienti për miratim një sërë formularësh standardë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në sa vijon: kërkesën e verifikuar për pagesë (faturë) nga Kontraktori, urdhrat e variacionit, udhëzimet e vendit, miratimin e punimeve, matjet e vendit etj., siç kërkohet nga ligji shqiptar;

- rishikon, verifikon, miraton dhe mban në dosje formularët dhe dokumentet e mëposhtme të përgatitura nga Kontraktorët: ditarët ditorë, ndryshimet në vizatime, fotografitë e progresit, nëse është e nevojshme dhe raportet ditore dhe vizatimet sipas ndërtimit, raporti i verifikimit të punëve të fshehura etj. Një kopje nga këto dokumente duhet të dorëzohet për regjistrim në NJKP dhe në MSHMS dhe çdo kërkesë pagese t'u bashkëngjitet atyre që kanë lidhje me të;

- të sigurojë që Kontraktori të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale gjatë periudhës së përgjegjësisë, duke përfshirë korrigjimin e të gjitha defekteve dhe kryerjen e punëve korrigjuese me cilësi dhe në kohë;

- kryen inspektime të rregullta të punimeve dhe themelon (nëse është e nevojshme) inspektoratin e punimeve në terren për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje teknike;

- përgatitja dhe mirëmbajtja e raporteve dhe e regjistrimeve të inspektimit dhe të inxhinierisë për të dokumentuar në mënyrë adekuate ecurinë e punimeve dhe performancën e Kontraktorit;

- mban takime zyrtare në terren të paktën një herë në muaj dhe shpërndan procesverbalet e takimeve;

- përgatit raporte javore të vendit për gjendjen e përditshme të punimeve, ecurinë e tyre, punën, materialet, impiantin, gjendjen e motit, orët e humbura të punës, vizatimet e marra dhe vizitat në vend;

- të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar që Kontraktuesi të përmbushë detyrimet e tij dhe t'i përmbahet rreptësisht orarit;

- ndjek testimin dhe vënien në punë të të gjitha pajisjeve.

III. Ndërtesat e përfunduara – dorëzimi

Konsulenti do të:

- inspektojë punimet përpara përfundimit fizik; do të listojë të gjitha punët e pazgjidhura pas përfundimit praktik dhe ndihmon Klientin në lëshimin e certifikatës së përfundimit të të gjitha

punimeve arkitekture dhe inxhinierike, dhe instalimin e pajisjeve mjekësore, dhe dorëzon zyrtarisht punimet ose pjesë të punimeve;

- kontrollon dhe miraton manualin e pronarit të ndërtesës, duke përfshirë udhëzimet e përdoruesit (nëse ka) dhe kërkesat e mirëmbajtjes për të gjithë artikujt dhe punët e parashikuara sipas kontratës, dhe vizatimet e ndërtuara të përgatitura nga Kontraktori;
- të sigurojë marrjen dhe ruajtjen si regjistrime të përhershme të të gjitha garancive të kërkuara, sipas kushteve të kontratës për materialet dhe pajisjet e pranura dhe të përfshira në Projekt;
- inspekton ndërtesat dhe instalimet vazhdimisht gjatë “periudhës së përgjegjësisë për defektet”, përgatit planin e defekteve dhe siguron korrigjimin e tyre përpara përfundimit të kësaj periudhe;
- përgatit llogaritë përfundimtare për miratimin e Klientit;
- kryen inspektimin përfundimtar dhe ndihmon Klientin në lëshimin e Certifikatës Përfundimtare.
- në përfundim të Projektit, i jep përfutjesit, pa pagesë, një kopje të plotë të vizatimeve të ndërtuara, të cilat regjistrojnë të gjitha ndryshimet nga vizatimet origjinale të punës;
- kontrollon dhe miraton manualin e pronarit të ndërtesës, duke përfshirë udhëzimet e përdoruesit dhe kërkesat e mirëmbajtjes për të gjithë artikujt dhe punët e parashikuara sipas kontratës, dhe vizatimet e ndërtuara të përgatitura nga Kontraktori;
- siguron marrjen dhe ruajtjen e të gjitha garancive të kërkuara sipas kushteve të dokumenteve të kontratës për materialet dhe pajisjet e pranura dhe të përfshira në Projekt;
- ndihmon stafin drejtues të spitalit për të krijuar një plan operimi dhe mirëmbajtjeje, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve kryesore në gjuhën shqipe.

5. ORARI I DORËZIMIT

Mbikëqyrja e punëve civile për rehabilitimin e Spitalit të Lezhës		
1	Raporti fillestar Në këtë raport konsulenti do të përfshijë një plan veprimi të detajuar dhe metodologjinë për zbatimin e fazës së tretë të këtij shërbimi dhe pritshmëritë e rezultateve, planin e zbatimit të Projektit	2 javë pas nënshkrimit të kontratës së punimeve civile
2	Raporti mujor i progresit (mbikëqyrja) , duke përfshirë takimet e terrenit dhe takimet e tjera	Mujore (gjatë gjithë zbatimit të punimeve civile)
3	Raporti i përfundimit të punëve civile , duke përfshirë dosjen e sigurimit të cilësisë	Llogaritet 16 muaj pas nënshkrimit të kontratës së punëve civile
4	Raporti i gjendjes gjatë periudhës 12-mujore të detyrimit (ose periudhë tjetër të përcaktuar nga ligji shqiptar)	Me përfundimin e punëve civile
5	Raporti përfundimtar (përfundimi i periudhës së garancisë së punimeve)	12 muaj pas përfundimit të punimeve (ose periudhë tjetër të përcaktuar nga ligji shqiptar)

6. KËRKESAT E RAPORTIMIT

Kompania e Konsulencës do t'i raportojë MSHMS-së/PCU-së dhe personelit të caktuar të MSHMS-së, në mënyrë periodike, çdo muaj ose më shpesh sipas nevojës, me gojë dhe me shkrim.

Kompania Konsulente do të punojë ngushtë me stafin teknik përgjegjës të MSHMS-së, zëvendësministrin dhe stafin e PCU-së për finalizimin e raporteve të kërkuara sipas këtij ToR-je. Miratimi teknik për çdo raport, sipas planit të mësipërm të produkteve, do të jetë përgjegjësi e koordinatorit të kontratës. Të gjitha raportet do të jenë të shkruara në shqip dhe në anglisht, secila në tri kopje origjinale dhe do t'i adresohen zyrtarisht:

- zëvendësministrit të Shëndetësisë/PCU;
- koordinatorit të Kontratës.

7. KUALIFIKIMET E KONSULENTIT

Kjo detyrë do të kryhet nga një firmë vendëse, e krijuar dhe funksionale, sipas legjislacionit, rregullave dhe rregulloreve shqiptare.

- Kompania Konsulente duhet të ketë të paktën 5 vjet përvojë në menaxhimin e ndërtimeve (mbikëqyrja e ndërtesave publike).
- Aftësi për të komunikuar dhe për të përgatitur dokumentet në të dyja gjuhët: shqip dhe anglisht.
- Referenca ose prova për të paktën 3 kontrata mbikëqyrjeje në 5 vjetët e fundit të kryera në territorin shqiptar (paraqitja e kontratave të ekzekutuara)
- Shoqëria Konsulente duhet të jetë në gjendje të sigurojë në versionin origjinal ose ligjor të certifikuar, licenca profesionale të vlefshme për mbikëqyrjen, si më poshtë:
- Konsulenti duhet të ketë një licencë të vlefshme “Mbikëqyrje”, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, duke përfshirë të gjitha kategoritë që mbulojnë punët e kërkuara sipas kësaj detyre.
- Konsulenti duhet të jetë i certifikuar për:
- ISO 9001-2008 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)
- ISO 14001-2004 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)
- OHSAS 18001-2007/ISO 45001 (stafi i konsulentëve kyç të sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë duhet të përbëhet nga stafet e mëposhtme, të cilat duhet të plotësojnë kriterin përkatës të mëposhtëm)

Kompania konsulente duhet të ketë licencat e mëposhtme të vlefshme të mbikëqyrjes:

- NP - 1 (punimet e gërmimit në tokë)
- NP - 3 (rikonstruksion dhe mirëmbajtje objektsh civile dhe industriale, veshje fasadash)
- NP - 7 (tubacionet e ujit, tubacionet e gazit, tubacionet e naftës, punimet e kullimit dhe ujitjes)
- NS - 1 (punimet për prishjen e objekteve)
- NS - 2 (hidrosanitare, kuzhina, lavastovilje, mirëmbajtje)
- NS - 4 (punimet e rifiniturës së muraturës dhe të ngjashme, rifinitura me materiale druri, plastikë, metali dhe qelqi dhe rifinitura teknike të ndërtimit)
- NS - 3 (sistemi i transportuesit ngritës)
- NS - 12 (uzinat teknologjike, termike dhe të ajrit të kondicionuar)
- NS - 14 (shtëpiake, elektrike, telefonike, radiotelefonike, TV etj.)

Konsulenti duhet të ketë staf adekuat për të kryer aktivitetet sipas kësaj detyre. Kualifikimet e pozicioneve kyçe përfshijnë:

Inxhinier civil - lideri i ekipit

- Të ketë diplomë në Inxhinieri Ndërtimi;
- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim në anglisht;
- Të ketë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në mbikëqyrjen e ndërtesave publike.
- Kualifikimet në vlerësimin sizmik dhe/ose në forcimin e strukturave të ndërtesave do të jenë një aset.

Arkitekt

- Të ketë diplomë në arkitekturë;
- Aftësitë drejtuese dhe menaxheriale;
- Të jetë në gjendje të komunikojë rrjedhshëm dhe të raportojë në anglisht me shkrim.
- Të ketë së paku 10 (dhjetë) vjet përvojë pune të përgjithshme relevante në mbikëqyrjen e ndërtesave publike.
- Eksperienca të mëparshme me përgatitjen dhe ekzekutimin e kontratave të punës sipas procedurave të BB-së.
- Përvoja e mëparshme e punës si udhëheqës ekipi në mbikëqyrje do të jetë një avantazh.

Inxhinier elektrik

- Të ketë diplomë në inxhinieri elektrike.
- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim në anglisht.

- Të ketë një minimum prej 10 (dhjetë) vjetësh përvojë në mbikëqyrjen shumëdisiplinore të publikut, ndërtesat dhe koordinimi i tyre.

Inxhinier mekanik

- Të ketë diplomë në inxhinieri mekanike.
- Të jetë në gjendje të komunikojë dhe të raportojë me shkrim, si në shqip, ashtu edhe në anglisht.
- Të ketë së paku 10 (dhjetë) vjet përvojë pune relevante në mbikëqyrjen e ndërtesave publike.

Ekspert i mjedisit

- Duhet të ketë një diplomë në inxhinieri mjedisore ose një fushë të ngjashme, si inxhinieri civile, kimike ose e përgjithshme. Punëdhënësit vlerësojnë, gjithashtu, përvojën praktike.
- Aftësi për të komunikuar dhe për të raportuar me shkrim në shqip dhe në anglisht.
- Duhet të ketë një minimum prej 5 (pesë)vjetësh përvojë pune përkatëse në fushën e inxhinierisë mjedisore.

Konsulenti mund të ofrojë, gjithashtu, ekspertë jokyç.

Shënim. Të gjithë ekspertët e mësipërm duhet të kenë licenca profesionale të lëshuara nga autoritetet shqiptare në fushën e ekspertizës së tyre, sipas pikës 7 më sipër, “Kualifikimi i konsulentëve”.

8. AFATI KOHOR PËR DETYRËN

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është Kualifikimi i Konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara të Bankës Botërore, rregulloret e prokurimit për huamarrësit e IPF-së (prokurimi në financimin e projekteve të investimeve të mallrave, punëve, shërbimeve jokonsulente dhe këshilluese, korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018).

Konsulenti do të angazhohet gjatë zbatimit të punimeve (e parashikuar për një periudhë 16-mujore), duke përfshirë DLP për 1 vit. Sidoqoftë, detyra duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2024.

Kontrata do të jetë e bazuar në kohë dhe konsulenti do të dorëzojë *timesheet* dhe raporte mujore (gjithashtu, artikujt e listuar në seksionin e mësipërm “Skedula e produkteve”). Kontributi total i të gjithë ekspertëve është vlerësuar 150 ditë pune (për të gjithë stafin së bashku).

Shoqëria mbikëqyrëse duhet të sigurohet që pagesat për shërbimin mbikëqyrës të paguhet në të njëjtën % të pagesave të kryera, në kuadër të punimeve civile. Koordinatori i kontratës do të marrë informacionin e nevojshëm për përqindjen e punimeve civile të aprovuar dhe të paguar dhe nuk do t’i miratojë ditët e punës kompanisë mbikëqyrëse që tejkalon % e realizimit të punimeve civile.

Raporti do të miratohet nga koordinatori i Kontratës i emëruar nga MSHMS-ja. Kostot dhe kontributet e kësaj konsulence janë llogaritur sipas ligjit shqiptar në fuqi.

Njoftim i rëndësishëm. Kjo kontratë konsulence do të nënskruhet vetëm nëse nënskruhet kontrata për ekzekutimin e punimeve civile (ose hyrja në fuqi e kësaj kontrate konsulence do të bëhet vetëm pas nënskrimit të kontratës për ekzekutimin e punimeve civile).

9. MJEDISI (PËRFSHIRË MASAT MBROJTËSE)

Strukturat ekzistuese të spitaleve do t’u nënshtrohen rikonstruksionit/ndërtimit të spitaleve të përmendura që do të mundësojnë modernizimin dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Objekti i punimeve nxit OP 4.01 për vlerësimin mjedisor, për shkak të zhurmës së mundshme, pluhurit dhe mbetjeve ndërtimore gjatë punimeve. Të gjitha këto ndikime janë adresuar përmes një plani të menaxhimit mjedisor të listës kontrolluese (PMM) që janë përgatitur dhe shpалosur në korrik 2014. Listat kontrolluese do të rishpalosen përpara fillimit të punimeve. Duke qenë se këto janë struktura ekzistuese me të gjitha lidhjet ekzistuese dhe praktikat e grumbullimit të mbetjeve me shkallën e punimeve relativisht të vogla, nuk parashikohen ndikime mjedisore afatgjata ose thelbësore që lidhen me këtë Projekt.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (REOI) (CONSULTING SERVICES)

Local Technical Assistance- Consulting Company

Tirana, 28th of August 2023

Additional Financing of Albania Health System Improvement Project (HSIP)

Loan No: 93060

Project ID Number: P144688

Assignment Title: Consulting Services for the Supervision for the rehabilitation of Lezha Hospital

Reference No. AL-MH-371202-CS-CQS

